

Data, 15.01.2022

Raport mbi aktivitetet e vitit 2021

Zbatimi i Nismës “Oendra e Këshillimit të Karrierës”, për të rinjtë e Lezhës.

Kjo nismë ishte pjesë e "Nismës Shkëndija", nismë e cila u zbatua nga CO-PLAN ALBANIA.

Në kuadër të kësaj nisme, ne kemi hartuar Modulën e Trajnimit për Psikologët dhe Punonjësit Socialë për mënyrën e organizimit të klasave të këshillimit të karrierës për të rinjtë në shkollat e Lezhës. Pas hartimit të këtij moduli, kemi realizuar 2 trajnime me psikologë dhe punonjës social për shpjegimin më në detaje të modulit dhe në fund një takim përmbyllës për të gjithë nismën.



Klubi i Debatit

Gjatë periudhës shkurt-qershor 2021, ne zhvilluam një sërë debatesh, të modeluara sipas debatit Karl Popper. Debatet me të rinjtë në qytetin e Lezhës janë zhvilluar në dy forma, online dhe fizikisht. Temat e trajtuara janë: Integrimi Evropian, Dullizmi, Të Drejtat e Njeriut, që prekin kryesisht të rinjtë dhe barazia gjinore. Në këto aktivitete janë përfshirë të rinj të grup moshave të ndryshme. Risia e këtyre aktiviteteve ka qënë zhvillimi i mendimit kritik tek këta të rinjë dhe të mësuarit mbi rëndësinë që kanë faktet e statistikave gjatë trajtimit të çështjeve të ndryshme.






Fushata sensibilizuese për të shmanqur përdorimin e plastikës njëpërdorimshme.

Të rinjtë e Përfshirjes Sociale për Zhvillim, i janë bashkuar fushatave sensibilizuese të projektit “Zona Plastike”. Ky projekt është zbatuar nga Milieucontact Albania. Të rinjtë por edhe anëtarë të stafit tonë i janë bashkuar fushatës si vullnetarë në projekt. Gjatë fushatave të rinjtë vullnetarë të organizatës, sëbashku me stafin e SIFD kanë sensibilizuar qytetarë dhe biznese të Lezhës mbi rëndësinë që ka ndlimi i përdorimit të plastikës një përdorimëshe.



Trajnimi “Vullnetarizmi”

SIFD ka mbajtur një trajnim me temë “Vullnetarizmi”. Në këtë trajnim morën pjesë 15 të rinj të moshës 12-20 vjeç. Çështjet e diskutuara në këtë trajnim kishin të bënin me konceptin e vullnetarizmit dhe ligjin për vullnetarizmin në Shqipëri. Ky trajnim është drejtuar nga Koordinatorja e Projekteve Znj.Vasilika Laska. Duke qënë se kishte eksperiencë në fushën e vullnetarizmit dhe projekteve, atëherë në mënyrë vullnetare ajo organizoi këtë trajnim me të rinjë dhe aktivistë të organizatës.



Kampi Veror i Vajzave Glow Camp

Në verën e vitit 2021, Përfshirja Sociale për Zhvillim organizon një kamp veror me 15 vajza të Bashkisë Lezhë, të moshës 14-20 vjeç. Gjatë tre ditëve vajzat jo vetëm që kaluan argëtim, por edhe mësuuan dhe edukuan. Tema qendrore e kampit ishte “Zakonet dhe traditat e Lezhës” Gjatë zhvillimit të Kampit, të rejat pjesëmarrëse paten mundësin që të vizitonin ambientet e Agroturizmit “Mrizi I Zanave”, që të kuptonin rëndësinë që ka trashëgimia kulturore, autenticiteti dhe se si këto gjëra unike për Lezhën mund të ruhen dhe të trashëgohen dhe në detaje të vogla.



Art Therapy

-Art Therapy me fëmijë, 04/2021

-Art Therapy me të rinjë 10,2021



2. por m

Në kuadër të zgjedhjeve për pushtetin qendror 2021, “SIFD” zhvilloi fushatën online “Voto, por mos e shit votën”. Në këtë fushatë u angazhuan 14 të rinj nga qarku i Lezhës, të cilët dhanë mesazhet e tyre për një proces zgjedhor me integritet. Të rinjtë pjesëmarrës ishin të moshës 14-22 vjeç dhe vinin nga prejardhje të ndryshme.




Dita Kombëtare e Aktivizmit - 22 Tetor 2021

Në Ditën Kombëtare të Aktivizmit në Shqipëri, “SIFD” ka organizuar një takim me të rinjtë. Me temën “Të rinjtë për qytetari aktive:”. Ky takim u zhvillua me të rinjtë e shkollës 9-vjeçare “Nënë Tereza”, Lezhë, duke iu bashkuar kështu maratonës së aktiviteteve të organizuara.



Seanca dhe takime me Psikologun e SIFD

Gjatë vitit 2021 “SIFD” ka ofruar shërbimin e këshillimit psikologjik, me psikologjen “Valentina Doda”, e cila e ka ofruar këtë shërbim për një vit të plotë në OJQ. Shoqëria Civile në Shqipëri, brenda kësaj date.



PËRGATITI

Koordinatore e Projekteve

VASILIKA LASKA

MIRATOI

Drejtoresh Ekzekutive

MARJANA DEDAJ